

Specialist/Sektor i Simulimeve të Incidenteve Kibernetike, Drejtoria e Qendrës Operacionale-CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik" i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 32, datë 16.03.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist/Sektor i Simulimeve të Incidenteve Kibernetike, Drejtoria e Qendrës Operacionale-CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Bashkëpunon me ekipin për realizimin e programit të brendshëm të punës;
- Realizon instalimin dhe konfigurimin e aplikacioneve 'Open Source' apo 'Proprietary', kur është e nevojshme;
- Realizon 'Penetration Testing', 'Vulnerability Assessment', bazuar në aplikacione të dedikuara për këto procese dhe "Cyber Tabletop Exercises";
- Realizon testimet lidhur me problemet e sigurisë dhe skenarët e mundshëm, bazuar në skanime manuale dhe të automatizuara;
- Analizimi i rezultateve të testeve të sigurisë, nxjerrja e përfundimeve nga rezultatet dhe zhvillimi i testeve shtesë, nëse është e nevojshme;
- Dokumenton dhe raporton problematikat e gjetura gjatë skanimeve dhe jep opinione për mundësitë e riparimit të problematikave;
- Identifikimi i çdo gjetje, që prodhohet nga programet shoqëruese, me departamentet e tjera të sigurisë kibernetike, si dhe me partnerët e biznesit dhe teknologjisë së informacionit të 'Cyber Security';
- Bashkëpunon ngushtë me ekipet e tjera të institucionit për të krijuar një raport të qartë të problemeve të sigurisë në infrastrukturat për të cilat janë realizuar testimet;
- Kryen me përpikëri detyrat e dhëna nga drejtuesi dhe në përputhje me procedurat dhe rregulloret e institucionit;

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, në Teknologji Informatike/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Informatikë Ekonomike.

Përvoja: Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion. Përbën avantazh eksperiencë e punës në fushën e Teknologjisë së Informatikës në fushën e sigurisë kibernetike dhe simulimeve të sigurisë së sistemeve.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Teknikat e sulmeve kibernetike dhe aplikacioneve që përdoren për këtë qëllim;
- Njohuri mbi protokollet e rrjetave kibernetike;
- Njohuri mbi metodat e sulmeve kibernetike;
- Njohuri mbi aplikacionet dhe platformat që përdoren për Sigurinë Kibernetike;
- Njohuri mbi fushën e sigurisë së informacionit;
- Vlerësimin e dobësive dhe sigurinë e rrjetit.

Aftësi për të:

- Gjithashtu do të posedojnë aftësi analitike dhe zgjidhje-problemi të shkëlqyera, aftësinë për të punuar si në forma individuale, ashtu edhe si pjesë e një ekipi, dhe aftësitë e forta të komunikimit dhe dokumentimit;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-I)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 27.10.2023, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;

- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.